Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[**Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit**]

Shtojca 4

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Blerje artikuj të ndryshëm ushqimorë për nevojat Bashkia Shkodër (shkolla Speciale 3 Dhjetori)

BUKE

Buka e grurit do të prodhohet me miell rreze 70 %, i stazhionuar për një periudhë prej 10-30 ditësh. Mielli duhet të jetë i freskët, me ngjyrë, erë, shije dhe lageshtirë konforme standarteve perkatese të miellit me rreze 70 %. Mielli nuk duhet të ketë asnjë lloj lende të huaj. Buka duhet të ketë formë të drejtë dhe normale, pa deformime dhe sipërfaqja e bukes duhet të jetë e lëmuar dhe pa plasje të ndryshme. Vellimi i bukes duhet të jetë i mjeftueshëm. Shija, era, lageshtira dhe aciditeti i bukes duhet të jetë konforme standartit teknik të prodhimit të saj. Korja e bukes – duhet të jetë e lëmuar, pa djegie, pa shkeputje të saj nga tulli, ngjyra e njellojtë, mjalti në të kuqerremte, në të gjithë sipërfaqen. Tulli duhet të jetë i pjekur mirë, me porozitet të imët në të gjithë vëllimin e tij dhe nuk duhet të ketë gjurmë mielli të pabrumosura. Nuk pranohet buke e shtypur, e deformuar, e papjekur, e djegur, me erë të huaj, me shije të hidhur e të tharte, me lende të huaja, me lageshtirë jo normale, me shije myku. Treguesit fiziko – kimik: Buka preferohet në formë katerkendeshe dhe me peshe 1(një) kg, lageshtira jo më shumë se 44.5 %, poroziteti jo më pak se 72%, aciditeti jo më shumë se 45% si niveli proteinik jo më pak se 12 %. Furnizimi i bukes do të bëhet çdo ditë pranë magazinave sipas kërkesës. Amballazhi i transportimit të bukes duhet të jetë i pastër dhe të sigurojë mos demtimin e saj. Mjetet transportuese duhet të jenë të pastra, të mbyllura që të sigurohet transportim normal i bukes deri në destinacionin perkates. Transporti të bëhet me mjete e të miratuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

MAKARONA

Lloji: Makarona të thjeshta spageti ose forma të tjera sipas porosisë së blerësit.

Pamja: Të jenë me formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpra, lejohen deformime të vogla, mbas zierjes të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen e të mos krijojnë shkumë.

-**Ngjyra:** E bardhë me nuancë të verdhë në thyerje, paraqiten qelqore në jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.

-**Era dhe shija:** E mirë karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe cfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

Treguesit fiziko-kimik: Lagështira deri në 13%, aciditeti jo më shumë se 0.16%, rritja e volumit jo më pak se dy herë. Nuk lejohen dëmtues.

Amballazhimi: Makaronat të jenë të ambalazuara në qeska polietileni me masë 0.5 kg, të paketuara në kuti kartoni. Makaronat të jenë të pajisur me etikete në gjuhën shqipe sipas kërkesave ligjore dhe në etikete të shenohet data e prodhimit, data e skadencës si dhe origjina e produktit. Shënimet duhet të jenë të qarta e lehtësisht të lexueshme. Emri prodhuesit duhet të jetë i dallueshëm, me tregues të qartë dhe afate garancie. Duhet të ketë etiketë shtesë në gjuhën shqipe.

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore. Transporti të bëhet me mjete të miratuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

NISESHTE

Lloji: Niseshte cilësia e parë prodhim vendi ose importi.

Ngjyra: E bardhë me nuancë të lehtë në të verdhë.

Era dhe shija: Të ketë erë dhe shije normale, pa erë myku ose shije tjetër të huaj, të thartë etj.

Ambalazhimi: Të jetë i ambalazhuar me qese të rregullta e të ambalazuara me mabalazhim sipas standartit ligjor për ambalazhimin në kontakt me ushqimin. Në ambalazh vendoset etiketa dhe në etikete të shenohet data e prodhimit, data e skadencës si dhe origjina e produktit. Ku shënohen: Ndërmarrja prodhuese, Lloji i niseshtes, data e prodhimit, data e skadencës.

Dorëzimi i mallit: Duhet çdo parti malli të shoqërohet me raportanalize

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore. Transporti të bëhet me mjete të miratuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

VEZË:

STASH 1515 / 85

Lloji: Vezë pulë.

Pamja e jashtme: E pastër, pa plasje, lejohen ndotje të lehta.

E bardha e Vezës: E dendur, e kulluar, e pastër dhe pa njolla gjaku.

E Verdha e Vezës: Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e lëvizshme.

Etiketimi: Të jenë të vulosura në sipërfaqe me vulën përkatëse.

Era dhe Shija: Pa erë dhe shije të huaj.

Masa: Jo më pak se 40 gr.

Amballazhimi: Të jenë të vendosura në bikurina e të sistemuara në arka kartoni. Në amballazhe të vendoset etiketa ku shënohen: Emri prodhuesit, sasia, data prodhimit.

Transporti: Të bëhet me mjetet e shitësit me kushte të mira higjieno-sanitare. Transporti të bëhet me mjete e të miratuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

KRIPË USHQIMORE E JODIZUAR

STAZH:

1437\01.07.1995

Treguesit cilësorë:

1. Ngjyra:

E bardhë

2. Era dhe shija:

E kripur pa shije dhe erë të huaja.

3. Pamja e jashtme: Masë kokrrizore

Treguesit fiziko-kimik:

1-Imtësia në mm 0.2–2.

2-Klorur Na në lëndën e thatë në %, jo më pak se 98.

3- Klorur Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

4-Sulfat Mg në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.9.

5-Sulfat Ca në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.2.

6-Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në %, jo më shumë se 0.3.

7-Lagështirë në %, jo më shumë se 1.

8-Jodur kaliumi mg/kg 50 (+/-)3

Markërimi:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimor. Këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

Amballazhimi:

- Të bëhet në qese të pastër ose polietileni ushqimor, me masë 0.5 kg. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpëtohet nga ambalazhi. Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të plotësojë standardet e parashikuara ligjore për ambalazhin në kontakt me ushqimin

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë. N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës orgjinale. Malli të shoqërohet me certifikatë origjinale dhe raport analizë të laboratorit

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore. Transporti te behet me mjete e te miratuara nga Autoriteti Kombetar i Ushqimit.

ORIZ

STASH: 1738 – 87. zv. 1738-84,1451-85

Pamja: Të jenë kokrra të pastra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shenja myku ose prishje.

Ngjyra: E bardhë,

Era dhe shija: Karakteristike e Orizit të shëndoshë, pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe çfarëdo ere tjetër të huaj.

Lagështia jo më shumë se 15%

Lëndë të huaja, jo më shumë se 0.2

Kokrra të thyer jo më shumë se 8%

Nuk lejohen dëmtues hambari, lëndë minerale, kokrra të pazhvilluara ose të mykura.

Ambalazhimi: Orizi të jetë i ambalazhuar në pako standarte me peshë 1 kg. Etiketa e produktit duhet të fiksohet që të mos shkëputet ku të jenë shkruar prodhuesi dhe afatet e skadencës. Materiali qe perdoret per ambalazhim duhet te p[lotesoje standartet e parashikuara ligjore per amabalazhin ne kontat me ushqimin.

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore. Transporti te behet me mjete e te miratuara nga Autoriteti Kombetar i Ushqimit.

VAJ USHQIMOR

STASH 203–2002

Lloji: Vaj ushqimor luledielli i rafinuar

Pamja: Lëng vajor i qartë pa depozitime

Ngjyra: E verdhë e lehtë

Era dhe shija: Karakteristike e vajit të lulediellit, pa shije dhe erë të huaj.

Treguesit Fiziko-Kimik:

Aciditeti si acid oleik 0.2 gr në 100 gr/Vaj.

Lëndë të pasapunifikueshme jo më shumë se 15 g/kg

Ambalazhimi: Vaji të jetë i ambalazhuar në shishe plastike me vëllim 1 litër me tapë plastike me vidhëzim të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse, të sistemuara në kuti kartoni. Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të përfshijë standardet e parashikuara ligjore për ambalazhin në kontakt me ushqimin, sepse vetëm kështu shmangë ndonjë ekuivok në specifikime. Etiketa duhet të jetë e fiksuar, të jetë shkruar qartë prodhuesi dhe afati i përdorimit. Duhet të jenë të pajisur me etikete në gjuhën shqipe sipas kërkesave ligjore dhe në etikete të shënohet data e prodhimit, data e skadencës si dhe origjina e produktit.

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore. Transporti të bëhet me mjete të miratuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

BULMETRA

Qumeshti

Te jetë i freskët, i pasterizuar dhe i sterilizuar. Të mos ketë në përbajtjen e tij lende konservuese dhe neutralizuese. Të plotësojë treguesit organo-leptike dhe fiziko-kimike. Ambalazhimi të jetë brenda kushteve higjieno-sanitare. Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të përfshijë standardet e parashikuara ligjore për ambalazhin në kontakt me ushqimin, sepse vetëm kështu shmangë ndonjë ekuivok në specifikime. Ruajtja dhe transportimi me temperaturë 2 deri në 8 gradë. Me mjete të transportit miratuara nga AKU pasi kjo kompetencë i ka kaluar AKU Përbajtja e yndyrës deri në 2-3 %

DJATHË I BARDHË

Bazuar në STAZH....1410 \87

Treguesit shqisorë:

1. Forma:

Prizëm, trekëndësh me faqe anësore cilindrike.

2. Pamja e jashtme dhe e brendshme:

E formuar mirë, e pastër e pa njolla, pa lëndë të huaja. Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe. Në prerje është e njëllajtë, e pastër, pa lëndë të huaja, me sythe teknike, me ngjyrë të bardhë deri në krem.

3. Struktura:

E lëmuar, e butë pa dallim shtresash.

4. Shija dhe era:

E kënaqshme, specifike e djathit të butë të stazhionuar, pa shije të hidhur e djegëse dhe pa shije

dhe erë të huaj.

Treguesit fiziko-kimik

1-Lagështira në %, jo më shumë se:

Për periudhën 1 Prill-30 Qershor – 52.

Për periudhën 15 Shtator-31 Mars – 56.

2- Lëndët e thata në %, jo më pak se:

Për periudhën 1 Prill-30 Qershor – 48.

Për periudhën 15 Shtator- 31 Mars – 44.

3-Yndyra në lëndët e thata në %, jo më pak se 50.

4-Kripë në % deri 4 +/- 1.

Amballazhimi:

Në voza plastike me vëllim 20-30 litër.

Djathi në vozë qëndron i mbuluar me shëllirën fillestare, e cila përmban 10–14% kripë deti.

Mbi çdo amballazh me djathë, vendoset etiketa në të cilën shënohen:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimor. Këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë. Etiketa e produktit të amballazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpëputet nga amballazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit. N.q.s është i mbuluar me një material veshës, të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e amballazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë. N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale. Malli të shoqërohet me çertifikatë cilësie të lëshuar nga institucione të licensuara dhe raport analiza të laboratorit.

Ruajtja: Djathi i bardhë duhet të ruhet në frigorifer në temperaturë 3-5 gradë dhe lagështi relative të ajrit rreth 95%. Koha e ruajtjes në këto kushte është deri në 12 muaj. Sipas kushteve të ruajtjes të percaktuara në etiketën që shoqëron produktin

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore. Transporti të bëhet me mjete frigoriferike të miratuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

KOS

Kërkohet kos i freskët natyral i pasterizuar dhe i përgatitur konform kërkesave të standartit të stash 144387 dhe të ligjit për ushqimin.

Kërkohet kos lope dhe dele i ambalazhuar në ambalazhe plastike të posaçme 500 gr. Ngjyra e kosit të jetë e bardhë dhe lehtësisht në krem, struktura të jetë e ngjeshur pa pore në prerje pa shtresa dhe ndarjehirë, era dhe shija të jenë të këndshme karakteristike e kosit të ëmbël, lehtësisht e thartë. Përmbajtja në % e yndyrës deri 3%. Çdo copë të ketë etiketën me gjithë të dhënat e kërkuara, Prodhuesi, lloji i kosit, pesha, data e prodhimit, treguesit fiziko – kimik etj.

Kosi të jetë i ambalazhuar në paketime 1 litërshe.

Kosi ruhet në frigorifer.

Afati skadencës do të jetë jo më shumë se 1 muaj nga koha e furnizimit. Etiketa të jetë e qartë me të dhënat përkatëse të përbërësve si dhe të prodhuesit.

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore.

Transporti të bëhet me mjete frigoriferike të miratuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

PRODUKTE MISHI

SALLAM

Me përbërje mish lope i papërzier, i freskët, prodhim ditor, të jenë të shoqëruara me etiketën e prodhuesit dhe i pajisur me certifikatën sanitare, të mos përmbajë shumë yndyra dhe të sillet i paketuar në porcionet (sasi) që bëhet kërkesa. Mishi të jetë ngjyrë rozë dhe të ketë erë të këndshme, fundet të jenë të lidhura mirë, pamja e brendshme në prerje tërthore të paraqesë një masë përzierje të njëtrajtshme, pa boshllëqe ajri, me ngjyrë natyrore të mishit të kuq rozë pa njolla të errëta. Mishi dhe dhjami të jenë të shpërndara njëllor në të gjithë sipërfaqen. Qëndrueshmëria elastike dhe gjatë shtypjes të mos ngelen shenja. Era e këndshme karakteristike për erëzat e përdorura, yndyrnat jo më shumë se 23% dhe kripë jo më shumë se 2–3%. Ngarkesa mikrobike të jetë brenda normave të lejuara nga Instituti i shëndetit Publik. Afatet e skadencës së mallit të jenë jo më pak se 2 muaj nga data e lëvrimit të mallit.

Transporti: Do të bëhet me mjete frigoriferike të furnizuesit deri në destinacion. Transporti të bëhet me kushte të mira higjeno-sanitare. **Mishi të jetë i shoqëruar me certifikatën veterinare për cdo furnizim.** Të gjitha prodhimet e mësipërme duhet të jenë të kontrolluara e të vulosura me vulën e mjekut veterinar. Të miratuar nga AKU

MISH PULE IMPORTI

Specifikimet teknike:

1. Kërkohet mish pule që të plotësojë kërkesat e standartit shtetëror.
2. Kërkohet vetëm kofshë pule.
3. Kërkohet cilësia e parë sipas standartit.
5. Paketimi në ambalazhimin origjinal ku të dallohet qartë koha e prodhimit dhe e skadencës dhe mbi të gjitha me vulë kontrolli të cilësisë.

6 Porosia sipas Autoritetit Kontraktor.

7. Jo të ngrira plotësisht.

Transporti: Do të bëhet me mjete frigoriferike të furnizuesit deri në destinacion. Te miratuar nga AKU Transporti të bëhet me kushte të mira higjieno-sanitare. **Mishi të jetë i shoqëruar me certifikatën veterinare për çdo furnizim.** Të gjitha prodhimet e mësipërme duhet të jenë të kontrolluara e të vulosura me vulën e mjekut veterinar.

MISH I GRIRË

Të jetë i freskët, lope jo në gjendje të ngrirë, i pakëtuar në qese plasmasi sipas porosive, me erë të këndshme, i bluar brenda ditës që kërkohet. Mishi të mos përmbajë yndyra të shumta me 10-15% të peshës, të jetë i pajisur me certifikatën e institucionit veterinar dhe të ketë ngjyrë rozë, të mos përmbajë elementë të huaj si kocka etj.

Transporti: Do të bëhet me mjete frigoriferike të furnizuesit deri në destinacion. Transporti të bëhet me kushte të mira higjieno-sanitare. **Mishi të jetë i shoqëruar me certifikatën veterinare për çdo furnizim.** Të gjitha prodhimet e mësipërme duhet të jenë të kontrolluara e të vulosura me vulën e mjekut veterinar.

ZARZAVATE E FRUTA

FASULE

STASH 1743 - 87

Treguesit shqisor: Pamja të jetë kokrra të shëndosha e të plota, jo të thërmuara, të bardha, pa erë myku, lagështia deri në 15%, thyeshmëria deri në 13%, lëndë të huaja deri në 0.8%, dëmtime nga insekticidet nuk lejohen.

Amballazhimi: Fasulet të jenë të ambalazhuara në qese të pastër, të thatë, të dizinfektuar dhe pa erë të huaj. Fasulet duhet të jenë të ambalazhuara në pako 1 kg. Etiketa duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpëputet nga ambalazhi. Shënimet duhet të jenë të dukshme dhe lehtësisht të lexueshme. Emri i produktit duhet të bjerë në sy në pamje të parë. Të jetë etiketuar afati garancisë me afat jo më shumë se dy muaj nga magazinimi.

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore.

Të jenë të cilësisë së parë, të freskëta, të mos kenë shenja të dëmtimit apo të kalbura. Ngjyra e verdhë në të gjelbërt.

BANANE

Të jenë të cilësisë së parë, të freskëta, të mos kenë shenja të dëmtimit apo të kalbura. Ngjyra e verdhë në të gjelbërt.

Madhësia mesatare dhe të mëdha. Mundësisht të një mase.

Të ambalazhura në kuti mesatare që të evitohen dëmtimet.

Frutat të jenë të pjekura normalisht. Furnizimi ditor. Diametri jo më pak se 3 cm.

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore.

SALCË DOMATE

Bazuar në STAZH 1429\87

Lloji: Salcë domate shishe.

Treguesit shqisorë: masë e njëllajtë me konsistencë pastë, jo fibroze, pa fara, pa copa lëkure, pa pjesë të karamelizuara të prishura ose të fermentura.

Ngjyra: E kuqe intensive karakteristike e salcës së domates e njëllajtë në të gjithë masën.

Era dhe shija: Karakteristikë e domates pa shije dhe erë të huaj, pa shije karamelizimi, prishje ose fermentimi.

Aciditeti i përgjithshëm në raport me ekstraktin i shprehur në acid acetik në % jo më shumë se 0.1. Ngarkesa mikrobike brenda kufinjve të lejuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Në salcën e domates nuk lejohen përmbajtje e lëndëve të huaja dhe përdoruesi i ngjyresve artificial.

Amballazhohet në shishe qelqi 700 gr. Mbi çdo amballazh vendoset etiketa e cila duhet të përmbajë të dhënat, llojin e prodhimit, afatet e përdorimit dhe prodhuesit. Nuk lejohet me afat skadence më shumë se 1 vit nga data e furnizimit. Malli të jetë i shoqëruar me çertifikatë të cilësisë dhe të standarteve të miratuara. Në etiketë të jetë shënuar data e prodhimit, data e skadencës.

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore.

QEPË E THATË

STASH 1755\88

Kërkohet cilësia e parë, të jetë me pjekuri të plotë, me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota, me ngjyrë e formë tipike të kultivuarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 7 cm.

Madhësia e kokrrës për ovalet të jetë nga 4-8 cm dhe për llojet e tjera 5-10 cm.

Lejohen jo më shumë se 1% e partisë me dëmtime të lehta dhe 1% lëndë të huaja.

Me sëmundje nuk lejohen.

Të ngrira, të kalbura e të mykura nuk lejohen.

Amballazhimi në thasë në masën 20-30 kg

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore.

Recel të frutave të ndyshme

Te jete i fresket ne kushte optimale per konsumim ne sasine 1.kg me afat skadences do te jete jo me pak se dy muaj pas dites se furnizimit. Te jete cilesor, me ngjyre dhe shije karakteristike,i etiketuar sipas standartit shteteror. Te jete I amballazhuar ne ene te mbyllura hermetikisht, jo me te medha se 1 kg, me date skadence mbi nje vit nga data e furnizimit.Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU.

Sode Buke

Te jete pluhur me ngjyre te bardhe, me eren karakteristikete sodes se bukes.Te mos kete lageshtire dhe erera te huaja

SUPË PULE (DADO):

Do të jenë sipas porosisë së konsumatorit të paketuara me peshë 100 gr, të etiketuara dhe në kuti kartoni. Afati skadencës do të jetë jo më pak se dy muaj pas ditës së furnizimit.

Transporti do të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore.

QESE PLASTIKE

Të jenë të madhësisë sipas kërkesës për produktet.

MAJA

Maja birre. Ngjyra dhe era karakteristike e majasë së berrës, e njëtrajtshme pa njolla, pa lëndë të huaja. të jetë në masë brumi 20 e më poshtë.

Amballazhimi: Në pako letre me peshë 1 kg. Mbi amballazh të vendoset etiketa ku shënohen të dhënat. Emërtimi i prodhuesit, Emërtimi i produktit, Peshë neto ose vëllimi i produktit, Data e prodhimit, Data e skadimit, Kushtet e veçanta të ruajtjes.

ERËZA MI.

Amballazhi plastik, paketimi 1kg.

Përbërësit: Kripë gjelle, perime të thata (karrotë, pastinak, qepë, rrënjë të selinosë), përforcues të aromës, amidon misri, sheqer, erëza (gjethe majdanozi, spec, hudhër pluhur), ngjyrë natyrore, aromë.

Operatori furnizues duhet të paraqesë fletë analizat nga AKU sa herë që i kërkohen nga pritësi i mallit.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Blerje ushqime per Qendren e Zhvillimit Shkoder

Afatet e l vrimitt: Nga nenshkrimi i kontrates deri me 31.12.2024

Nr	Emertimi I Produktit	njesia	sasi
1	BAKLLAVE	cope	10
2	BANANE	kg	1000
4	BISKOTA	kg	190
5	BIZELE	kg	40
7	BUKE 700g	cope	8000
8	CAJ (pako 0.5 kg)	pako	20
10	COKOKREM 900g	cope	480
11	DJATH I BARDHE	kg	500
13	DJATH KACKAVALL	kg	50
14	EREZA qese te vogla	cope	340
16	FASULE	kg	150
17	FILETO PULE	kg	50
19	FUTA DHE PERIME TE STINES	kg	4900
20	GJALPE	kg	360
22	HUDHRA	kg	5
23	KADAIF	kg	10
25	KONSERVA PESHKU 100g	cope	100
26	KOS FRUTASH	cope	3500
28	KOS LITER	Liter	1600
29	Krem Karamel(buding)	pako	200
31	KREMVIC	kg	50
32	KRIPE	kg	200
34	LENGJE FRUTASH	liter	1200
35	MAJDANOZ	tuba	650
37	MAJONEZ 400g	cope	150
38	MAKARONA	kg	1300
40	MARTEDELE PARIZIER	kg	60
41	MIELL GRURI	kg	150
43	MISH I GRIRE VICI	kg	200
44	MISH PULE	kg	600
46	MISH VICI	kg	350
47	NIESHTE	kg	10
49	ORIZ	kg	950
50	PANA GATIMI 250g	cope	200
52	PETE BYREKU	pako	150

53	PULA TE PLOTA	kg	50
55	QEBAP	cope	13000
56	QUMESHT	liter	2880
58	RECEL	kg	300
59	SALCE PURE 700G	cope	600
61	SALLAM	kg	720
62	SHEQER	kg	670
64	SIMITA 100G	cope	2150
65	SODE BUKE	pako	70
67	SUPE PULE pako 6cop	pako	250
68	VAJ LULEDIELLI	liter	530
70	VAJ ULLIRI	liter	100
71	VEZE	cope	900
73	AKULLORE	kg	30
74	MJALTE	kg	30
76	PURE PATATE	pako	200
77	KAFE	kg	20
79	UTHULL	Liter	30
80	PETULLA TE GATESHME	kg	500
82	TURSHI TE NDRYSHME	kg	30

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. *Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2021, 2022 dhe 2023) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës e përkatësisht **3 920 000 (te milion e nentëqind e njetëzete mijë) lekë**.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2021, 2022 dhe 2023 ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit në një vlerë jo më të vogël se 20 % fondit limit prej **1 960 000 (një milion e nentëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë**, të ekzekutuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

2.3.2 Operoret ekonomik duhet të paraqesë **Licencë të kategorisë “II.1.B- Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit”**.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatat përkatëse të vlefshme si më poshtë:

- Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001:2015**. Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet
- Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një çertifikatë që vërteton cilësinë e sistemit të menaxhimit të sigurisë ushqimore, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 22000 ose ekuivalent**. Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës dhe të jetë e

lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

- 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë raport-analiza origjinale ose kopje të noterizuar të lëshuar nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i references për artikujt që prokurohen.
- 2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.
- 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira për periudhën e zbatimit të kontratës objektin njësi tregtare për shitjen e ushqimeve e pajisur me Leje -Higjenosanitare ose nëse është me qira duhet të paraqesin kontratën e qirase të vlefshme për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës dhe të figurojë e regjistruar në QKB si aktivitet.
- 2.3.7** Në rast se operatori pjesëmarrës nuk është prodhues, por do të përmbush kërkesat e AK me kontrata furnizimi, atëherë këto kontrata duhet të deklarohen sipas tabelës nr 1. Operatores palë të këtyre kontratave furnizimi duhet ta ushtronte aktivitetin e tyre konform legjislacionit në fuqi .

Tabela 1

Nr.	Emertimi i Artikullit	Prodhuesi/Distributori i autorizuar	Data e nënshkrimit të fillimit të kontratës së furnizimit	Data e përfundimit të afatit të kontratës së furnizimit
1				
2				
3				
4				
5				
Etj				

Shënim:

Kontratat e furnizimit për të gjithë artikujt objekt prokurimi **që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor përpara publikimit të fituesit paraprak.**

2.3.8 Subjekti ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera, nëpërmjet aktit të pronësisë ose kontrates notoriale te qerese, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, 2 (dy) mjete transporti te pershtatshem per transportin e produkteve ushqimore, të shoqëruar me leje qarkullimi, police sigurimi, akt kolaudimi, foton perkatese si dhe lejen higjeno-sanitare, ku njeri prej tyre te jete ATP (frigorifer) ndersa tjetri mjet ATV.

2.3.9 Ne daten dhe oren e caktuar per hapjen e ofertave,operatoret ekonomike duhet te paraqiten prane Autoritetit Kontraktor me mostrat e produkteve objekt i kontrates per tu bere vleresimi i tyre konform specifikimeve teknike.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----

Adresa postare:	-----
Qyteti / qyteti; Kodi postar	--
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: <hr/> <hr/> etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

